Kronikë

Po pinin alkool në lokal, i riu qëllon me armë zjarri shokun e tij në Borsh! Arrestohet nga policia, një tjetër shpallet në kërkim

Një plagosje me armë zjarri pistoletë ka ndodhur në fshatin turistik të Borshit mëngjesin e kësaj të enjteje. Një i ri është qëlluar me plumb në dorë teksa po pinte alkool në lokal me një shok. Policia ka arrestuar autorin e dyshuar, ndërsa është shpallur në kërkim edhe një tjetër person i përfshirë në konflikt.

Foto ilustruese

Redaksia
31 Korrik, 08:17 | **Përditesimi: 31 Korrik, 19:02**

Share

Himarë - Një plagosje me armë zjarri pistoletë ka ndodhur në fshatin turistik të Borshit mëngjesin e kësaj të enjteje (31 korrik). Sipas informacioneve rreth orës 02:20, një i ri është qëlluar me plumb në dorë teksa po pinte alkool në lokal me një shok.

Policia ka arrestuar autorin e dyshuar, ndërsa është shpallur në kërkim edhe një tjetër person i përfshirë në konflikt.

Dy miqtë mësohet se kanë nisur një debat në tavolinë dhe njëri prej tyre, Hekuran Çelaj ka nxjerrë armën duke qëlluar me pistoletë, Erald Shullazin.

LEXO EDHE:
Selenicë/ Zjarr në fshatin Brataj, era e fortë përhap flakët (VIDEO)

33-vjeçari me origjinë nga Kruja ka marrë një plumb në pjesën e dorës ndërsa tashmë ndodhet në spital ku po merr ndihmë mjekësore.

Hekuran Çelaj, autori i dyshuar filimisht është arratisur nga vendi i ngjarjes. Megjithatë arratisja ka zgjatur shumë pak pasi bluté e Himarës arritën të ndalonin autorin dhe një person tjetër, konkretisht Albert Dollaku.

Njoftimi i policisë:

> *Borsh, Himarë/Vijojnë veprimet hetimore për ngjarjen e ndodhur në orët e para të mëngjesit të sotëm, në fshatin Borsh, ku mbeti i plagosur me armë zjarri një shtetas. Arrestohet autori i dyshuar, shpallet në kërkim edhe një tjetër shtetas i përfshirë në konflikt.*
>
> *Më datë 31.07.2025, rreth orës 02:20, në një lokal në fshatin Borsh, Himarë, shtetasi Hekuran Çelaj,, 42 vjeç, banues në Borsh, dyshohet se është përfshirë në një konflikt fizik, për motive të dobëta, gjatë të cilit është goditur me grushte nga shtetasi E. V., 55 vjeç, banues në Tiranë. Pas këtij momenti, shtetasi Hekuran Çelaj është larguar nga ambientet e lokalit dhe është rikthyer me një armë zjarri automatik, me të cilën ka qëlluar në drejtim të automjetit tip "Volksëagen", me drejtues shtetasin Erald Shullazin, 33 vjeç, duke e plagosur në shpatull dhe në këmbë. Ky shtetas ndodhet aktualisht në spital, jashtë rrezikut për jetën. Gjithashtu, dyshohet se shtetasi Hekuran Çelaj, ka goditur me gytën e armës edhe shtetasin Albert Dollaku, 43 vjeç.*
>
> *Si rezultat i veprimeve të shpejta hetimore dhe procedurale nga Sektori për Hetimin e Krimeve të Rënda në DVP Vlorë, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit Hekuran Çelaj, për veprat penale "Vrasje me dashje", mbetur në tentativë, dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit". Gjithashtu, është shpallur në kërkim dhe shtetasi Edmond Vlashi, për veprën penale "Dëmtime të tjera me dashje".*

Xh.K/S.B/Shqiptarja.com

TAG: Hekuran Çelaj | Edmond Vlashi | Borsh | himarë | Vlorë | plagosje me arme zjarri | Erald Shullazi

Komento

Komente

Koburja: 31/07/2025 09:24

Shullazi Dollaku...kan te bojn me ata te fortet keta?

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Prokuroria, GJL e Dhoma Avokatisë kundër Kodit Penal, a duhet ndryshuar drafti?

30 Korrik, 15:42

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Himarë/ Parkoi gabim 'BMW' dhe i zuri rrugën Zjarrfikëses që po shkonte për një emergjencë, nën akuzë 22-vjeçari nga kryeqyteti! Merr dhe 20 mijë lekë gjobë (VIDEO)
31 Korrik, 10:38

Tentoi të parakalonte, motori përplaset me trailer-in në Levan-Vlorë! 2 të plagosur
31 Korrik, 10:32

Qafë-Botë/ I vodhi portofolin dhe kartat bankare pushuesit në Ksamil, arrestohet duke ikur në Greqi turisti hungarez! Në makinë i gjendet dhe përforcues grushti
31 Korrik, 10:15

Shkaktoi aksidentin ku vdiqën dy bashkëshortët në Borsh, 29-vjeçari i plagosur arrestohet te QSUT
31 Korrik, 10:01

Parku fotovoltaik përplas banorët me bashkinë e Sarandës! Demokratët bashkojnë votat me socialistët: 60 ha tokë i jepet me qira Xhindolit e Buzit

Limos Didani

30 Korrik, 17:01

Aksident i rëndë në Borsh, vdesin burrë e grua! Një tjetër në gjendje të rëndë! Fuoristrada që i përplasi ishte me 200 kilometra në orë (EMRAT+VIDEO)
30 Korrik, 14:24



Delvinë/ Ndezën zjarrin që dogji 18 banesa, kishën dhe 20 mijë rrënjë ullinj, nisin hetimet për 3 autorët (EMRAT)
30 Korrik, 13:39

Vlorë/ Mbajti me forcë bashkëmoshatarin në makinë, nën akuzë 34-vjeçari, mister shkaqet
30 Korrik, 13:22

Vlorë/ Gjykata e Fierit ia kishte sekuestruar, 41-vjeçari i ndërron bravën apartamentit
30 Korrik, 13:04

Sarandë/ Turisti hungarez vjedh në Ksamil portofolin me lekë dhe kartat bankare të pushuesit, policia e shpall në kërkim
30 Korrik, 12:58

Prokuroria e Sarandës liron 2 të arrestuarit e 'Delvina Gas': Ndalimi i Policisë i paligjshëm! Ende në kërkim biznesmeni Meqemeja

Limos Didani

30 Korrik, 11:43

Kamioncina digjet në aksin Vlorë-Fier, tymi 'mbulon' zonën
30 Korrik, 09:04

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje